**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e autorizimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Agnese Ibrahimi** | **28.09.2023** | **10.10.2023** | **2023/0732** |

## BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 26.09.2023, OE "PROFESSIONAL ALARM L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0732, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Vendosja e kamerave ne Kryeqytet" me nr. të prokurimit: "616-23-8456-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 1,200,000 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0732 i dt:26.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi;

Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore;

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Neni 27 Dosja e Tenderit;

Neni 28 Specifikimet teknike;

Neni 32 Rregullat e përgjithshme;

Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit;

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;

**Pretendimi ankimor 1:**

Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk e ka trajtuar në pajtim me nenin 108/A, paragrafin 3.1 të LPP-së. Citoj "3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave"; dhe ne perputhje me neni 5 paragrafi 1 te LPP-se dhe ne perputhje me rregulloren 001/2022 neni 60 paragrafi 1 pika a) si dhe ne perputhje me **interpretimin** e Komisionit Rregullativ te Prokurimit Publik interpretimi me nr.16 i dates 22.11.2022

Elaborim i kalkulimit te diteve ne baze te neneve te lartcekura:

26.09.2023 – data e dorzimit te ofertave (dita 0)
25.09.2023 – (dita e 1)
24.09.2023 – (dita e 2)
23.09.2023 – (dita e 3)
22.09.2023 – (dita e 4)
**21.09.2023 – (dita e 5) deri ne oren 16:00 sipas LPP-se neni 5 paragrafi 1**
20.09.2023 ne oren 17:43 ne kemi dorzuar kerkesen per rishqyrtim.

Pas kërkesës tonë për rishqyrtim pranë AK-së, kjo e fundit në platformën e-prokurimi ka ngarkuar disa përgjigje tjera dhe ka **fshirë** në platformën e-prokurimi të gjitha përgjigjet e mëhershme gjë që është rreptësishtë e ndaluar. Madje këto përgjigje edhe përkundër se janë dhënë 3 ditë para hapjes së ofertave AK nuk ka bërë zgjatjen e për ofertim ashtu siç

kërkohet në nenin 24, paragrafin 24.5 të Rregullores nr 001/2022 për Prokurimin Publik,

**Provë që janë fshirë përgjigjet e datës 13.09.2023 te ngarkuar ne sistemin e e-prokurimit ne ora 15:45**

Wed 13.09.2023 15:45

eprokurimi@rks-gov.net

Autoriteti Kontraktues Vendosja e kamerave ne Kryeqytet ka publikuar sqarim te dosjes së tenderit në pr
/ Contracting authority Vendosja e kamerave ne Kryeqytet has published clarification of the tender doss

To info@professionalalarm.eu

I nderuar/ E nderuara,

Autoriteti Kontraktues **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** publikoi Sqarimin e Dosjes së Tenderit / dokumentit të parakualifikimit lidhur me pr **Vendosja e kamerave ne Kryeqytet** për të cilën ju keni shprehur interes.

Dokumenti mund të shkarkohet këtu

Një kopje të këtij mesazhi ju mund ta gjeni në sistemin elektronik të prokurimit publik të Kosovës. Pas kyçjes në sistem, në menynë MESAZHET zgjedl mia.

Nëse keni pyetje shtesë, ju lutemi kontaktoni shërbimin Help Desk.

Gjithë të mirat, KRPP
Help Desk Service
telefon (ditë pune): (038) 200 82 000
e-mail: eprokurimi.helpdesk@rks-gov.net

Dear Sir/Madam,

Contracting authority **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** published Tender Dossier clarification related to procedure **Installing cameras in** which you expresed interest.

Document can be downloaded from here

You can find copy of this message in electronic public procurement system of Kosovo. After log-in, in menu MY NOTIFICATIONS select My inbox.

If you have any additional questions, please contact Help Desk Service.

Best regards, PPRC
Help Desk Service
telephone: (038) 200 82 000
e-mail: eprokurimi.helpdesk@rks-gov.net

**OE Professional Alarm**

Pyetje 1
**Përgjigje 1. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 2
**Përgjigje 2. Kjo është kërkesë e caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 3
**Përgjigje 3. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 4
**Përgjigje 4. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 5
**Përgjigje 5. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 6
**Përgjigje 6. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 7
**Përgjigje 7. Këto specifika teknike nuk përfaqsojnë vetëm një prodhues të vetëm dhe nuk jan bazuar në një prodhues por janë bazuar në zgjidhje.Kjo është e pershkruar në dokumentin e Planifikimit për implementim të sistemit të Video Vëzhgimit faqe 8.**

Pyetje 8
**Përgjigje 8. Ky shënim ka mbete nga draft dokumenti. Ju lutem referonu dokunentit në gjuhën shqipe.**

Pyetje 9.
**Përgjigje 9 Kjo është kërkesë e caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 10.
**Përgjigje 10. Kjo duhet të vendoset nga Komuna e Prishtinës**

**OE *ELECTRONIC SHPK***

Pyetje 1
**Përgjigje 1. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 2
**Përgjigje 2. Kjo është kërkesë e caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 3
**Përgjigje 3. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 4
**Përgjigje 4. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

**Pretendimi ankimor 2:**
Autoriteti Kontraktues (AK), Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe 7, si dhe nenin 4.3 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik.

**Fakti 1**
AK nuk ka qenë fare transparent sa i përket kësaj procedurë të prokurimit dhe nuk ka trajtuar barabartë të gjithë Operatorët Ekonomik. Kjo është e vërtetuar edhe me përgjigjet të cilat i kemi pranuar me date 13.09.2023 pas kërkesës tonë për informata shtesë. Në kërkesën e parë thuajse në asnjë nga pyetjet nuk është ofruar përgjigje ndërsa kërkesës tonë të dytë nuk është përgjigje fare ne afatin e perrcaktuar dhe i ka kthyer pergjigjet me date 21.09.2023 ne ora 15:31 duke shkelur cdo afat te parapare sipas LPP-s dhe rregullore ne fuqi

1. Në dosje të tenderit mungojnë të dhënat bazë për projektin e për të cilin ne nuk kemi pranuar përgjigje:
2. • Nuk dihet lokacioni se ku do të bëhet instalimi i kamerave;
3. • Kerkesa per vizite ne teren nuk na është mundësuar;
4. • Nuk dihen dimensionet e kanaleve dhe si do te behet kabllimi dhe se a do të vendosen këto kabllo ne ajer apo do të jenë nëntokësore pyetje per te cilen nuk kemi pranuar pergjigje!
5.

AK- ka po ashtu ka vendosë kërkesa diskriminuese dhe të panevojshme duke përjashtuar nga konkurrenca OE të interesuar për këtë procedurë të prokurimit:

Është kërkuar një koordinator i certifikuar ITIL me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion, kërkesë kjo e panevojshme dhe diskriminuese duke pas parasysh llojin e aktivitetit të prokurimit;

Për menaxherin e projektit është kërkuar 5 vite përvojë pune në profesion pas diplomimit. Kërkesë diskriminuese.

Është kërkuar MAF për kamera dhe NVR (Autorizim nga Prodhuesi), ndërsa në anën tjetër keni specifikuar pajisje të cilat i përshtaten vetëm prodhuesit Avigilon dhe nuk ka lene mundesi te dorezohet DAF. Kërkesë diskriminuese me te vetimin qellim eleminimin e konkurences per arsyse se te favorizimit te drejtperdrejt te OE ti cilit i jane pershtatur edhe specifikimet teknike edhe kriteret tjera diskriminuese.

Është kërkuar që NVR, kamera dhe switch të jenë të certifikuara dhe në pajtim me NDAA. Kërkese diskriminuese pasi qe NDAA eshte Akti i Autorizimit të Mbrojtjes Kombëtare te SHBA-se konkretisht urshtrise amerikane dhe nuk ka te beje asgje me teritorin e Republikes se Kosoves dhe nuk eshte kriter relevant qe duhet vendosej per kete aktivitet te prokurimit.

**Pretendimi ankimor 3:**
Siç dëshmohet edhe në kërkesën për sqarim të tenderit, si Autoritet Kontraktues, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, paragrafin 2 të LPP-së si dhe paragrafin 17.17 dhe 19.4 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik .
AK ka përpiluar specifikime teknike që favorizojnë vetëm një prodhues.
**Fakti 1 për pretendimin ankimor 3**

**Pozicioni nr.3 ne dokumentit karakteristikat teknike- KOMPONENTET E**

**KËRKUARA TË SISTEMIT HARDUERIK Regjistruesi i rrjetit të videove (NVR) dhe serveri i njohjes automatike të targave (ANPR) - TIPI 1**

Funksioni në sistem:

o Menaxhimi i transmetimeve të kamerës, menaxheri i bazës së të dhënave, transmetimi dhe ruajtja e materialit video deri në 70 kamera video survejimi

o Menaxhimi i transmetimeve të kamerës, menaxheri i bazës së të dhënave, transmetimi dhe ruajtja e materialit video deri në 8 kamera automatike të njohjes së targave (ANPR)

o mësimi i thellë i video analitikës për kamerat e lidhura në sistem

- Shtrirja e analitikës video duhet të përfshijë të paktën:

o Gjetja e personit në të gjitha faqet njëkohësisht (deri në 100 kamera njëkohësisht) - bazuar në formën, ngjyrën e veshjeve, ngjyrën e flokëve, gjininë, moshat dhe profilet e fytyrave

o Gjetja e automjetit në të gjitha faqet në të njëjtën kohë (deri në 100 kamera njëkohësisht) - bazuar në kategorinë dhe ngjyrën

o Njohja e fytyrës deri në min. 50 kamera

o Njohja automatike e targave me numra (ANPR) për deri në min. 8 kamera me rrjedhje të lirë.

- Konfigurimi i ruajtjes:

o të paktën 2x 480 GB SSD në konfigurimin RAID 1 për OS

o të paktën 432 TB kapacitet ruajtës efektiv regjistrimi në disqet Hot-Plug në konfigurimin RAID 60

- CPU:

o të paktën 2x CPU me frekuencë bazë minimale 8 bërthama 2.8 GHz dhe 12 MB cache; data e lëshimit jo më herët se T2/2021

- RAM:

o Së paku 64GB

- Ndërfaqja e rrjetit:

o Së paku 4× 1 GbE RJ-45 porte (1000Base-T)

o Së paku 2× 10 GbE Direct Attach SFP porte

- Performanca e transmetimit të videos në rrjet:

o Shpejtësia e regjistrimit: të paktën 1500 Mbps

o Shpejtësia e riprodhimit dhe transmetimit të drejtpërdrejtë: të paktën 600 Mbps

- Furnizimi me energji elektrike: i dyfishtë/ redundant

- Faktori i formës: montimi në raft

- Dorëzohet me sistem rrëshqitës me kabllo krahu i menaxhimit dhe të gjitha kabllot, lidhësit etj. të nevojshme për vënien në punë dhe kabllot SFP Direct Attach 2× 10 GbE

- Sistemi Operativ - në përputhje me zgjidhjen e ofruar, me licencë të përjetshme, i pajtueshëm me MS Active Directory

- Licencë SQL Server 2019 Standard (2 bërthama) ose e ngjashme për të trajtuar të dhënat ANPR

- NVR duhet të miratohet nga NDAA

- Të gjithë programet e tjera të palëve të treta me të gjitha licencat (nëse ka) të nevojshme për të siguruar funksionalitetin e plotë të sistemit

**Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është Avigilon modeli NVR5 PRM (252-432 TB) i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart.**

**Dëshmi: Datasheet nga prodhuesi per krahasim**

https://assets.avigilon.com/file_library/pdf/nvr/avigilon-nvr5-datasheet-en-rev2.pdf

**Fakti 2 për pretendimin ankimor 3**

**Pozicioni nr.4 ne dokumentit karakteristikat teknike- Regjistruesi i rrjetit të videove (NVR) dhe serveri i njohjes automatike të targave (ANPR) - TIPI 2**

- Funksioni në sistem:

o Menaxhimi i transmetimeve të kamerës, menaxheri i bazës së të dhënave, transmetimi dhe ruajtja e materialit video deri në 8 kamera automatike të njohjes së targave (ANPR)

o mësimi i thellë i video analitikës për kamerat e lidhura në sistem

- Shtrirja e analitikës video duhet të përfshijë të paktën:

o Gjetja e personit në të gjitha faqet njëkohësisht (deri në 100 kamera njëkohësisht) - bazuar në formën, ngjyrën e veshjeve, ngjyrën e flokëve, gjininë, moshat dhe profilet e fytyrave

o Gjetja e automjetit në të gjitha faqet në të njëjtën kohë (deri në 100 kamera njëkohësisht) - bazuar në kategorinë dhe ngjyrën

o Njohja e fytyrës deri në min. 50 kamera

o Njohja automatike e targave me numra (ANPR) për deri në min. 8 kamera me rrjedhje të lirë.

- Konfigurimi i ruajtjes:

o të paktën 2x 240GB SSD në konfigurimin RAID 1 për OS

o të paktën 24 TB kapacitet ruajtës efektiv regjistrimi në disqet Hot-Plug në konfigurimin RAID 6

- CPU:

o të paktën CPU me frekuencë bazë minimale 8 bërthama 2.8 GHz dhe 12 MB cache; data e lëshimit jo më herët se T2/2021

- RAM:

o Së paku 16GB

- Ndërfaqja e rrjetit:

o Së paku 4× 1 GbE RJ-45 porte (1000Base-T)

- Performanca e transmetimit të videos në rrjet:

o Shpejtësia e regjistrimit: të paktën 700 Mbps

o Shpejtësia e riprodhimit dhe transmetimit të drejtpërdrejtë: të paktën 600 Mbps

- Furnizimi me energji elektrike: I dyfishte/redundant

- Faktori i formës: montimi në raft

- Dorëzohet me sistem rrëshqitës me kabllo krahu i menaxhimit dhe të gjitha kabllot, lidhësit etj. të nevojshme për vënien në punë

- Sistemi Operativ - në përputhje me zgjidhjen e ofruar, me licencë të përjetshme, i pajtueshëm me MS Active Directory

- Licencë SQL Server 2019 Standard (2 bërthama) ose e ngjashme për të trajtuar të dhënat ANPR

- NVR duhet të miratohet nga NDAA

- Të gjithë programet e tjera të palëve të treta me të gjitha licencat (nëse ka) të nevojshme për të siguruar funksionalitetin e plotë të sistemit

**Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është Avigilon NVR5 STD(16-64 TB) i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart.**

**Dëshmi: Datasheet nga prodhuesi per krahasim**

**https://assets.avigilon.com/file_library/pdf/nvr/avigilon-nvr5-datasheet-en-rev2.pdf**

**Fakti 3 për pretendimin ankimor 3**

**Pozicioni nr.5 ne dokumentit karakteristikat teknike- Regjistruesi video i rrjetit Failover (NVR) dhe serveri i njohjes automatike të targave (ANPR) - TIPI 3**

Regjistruesi video i rrjetit Failover (NVR) dhe serveri i njohjes automatike të targave (ANPR) - TIPI 3

- Funksioni në sistem:

o Server failover që do të jetë në gjendje të marrë dhe menaxhojë transmetimet e kamerës, bazën e të dhënave, transmetimin dhe ruajtjen e materialit video deri në 70 kamera video survejimi dhe deri në 8 kamera automatike të njohjes së targave

o mësimi i thellë i video analitikës për kamerat e lidhura në sistem

- Shtrirja e analitikës video duhet të përfshijë të paktën:

o Gjetja e personit në të gjitha faqet njëkohësisht (deri në 100 kamera njëkohësisht) - bazuar në formën, ngjyrën e veshjeve, ngjyrën e flokëve, gjininë, moshat dhe profilet e

fytyrave

o Gjetja e automjetit në të gjitha faqet në të njëjtën kohë (deri në 100 kamera njëkohësisht) - bazuar në kategorinë dhe ngjyrën

o Njohja e fytyrës deri në min. 50 kamera

o Njohja automatike e targave me numra (ANPR) për deri në min. 8 kamera me rrjedhje të lirë.

- Konfigurimi i ruajtjes:

o të paktën 2x 480 GB SSD në konfigurimin RAID 1 për OS

o të paktën 432 TB kapacitet ruajtës efektiv regjistrimi në disqet Hot-Plug në konfigurimin RAID 60

- CPU:

o të paktën 2x CPU me frekuencë bazë minimale 8 bërthama 2.8 GHz dhe 12 MB cache; data e lëshimit jo më herët se T2/2021

- RAM:

o Së paku 64GB

- Ndërfaqja e rrjetit:

o Së paku 4× 1 GbE RJ-45 porte (1000Base-T)

o Së paku 2× 10 GbE Direct Attach SFP porte

- Performanca e transmetimit të videos në rrjet:

o Shpejtësia e regjistrimit: të paktën 1500 Mbps

o Shpejtësia e riprodhimit dhe transmetimit të drejtpërdrejtë: të paktën 600 Mbps

- Furnizimi me energji elektrike: i dyfishtë/ redundant

- Faktori i formës: montimi në raft

- Duhet të dorëzohet me 78 licenca kamerash

- Dorëzohet me sistem rrëshqitës me kabllo krahu i menaxhimit dhe të gjitha kabllot, lidhësit etj. të nevojshme për vënien në punë dhe kabllot SFP Direct Attach 2× 10 GbE

pajtueshëm me MS Active Directory

- Licencë SQL Server 2019 Standard (2 bërthama) ose e ngjashme për të trajtuar të dhënat ANPR

- NVR duhet të miratohet nga NDAA

- Të gjithë programet e tjera të palëve të treta me të gjitha licencat (nëse ka) të nevojshme për të siguruar funksionalitetin e plotë të sistemit

**Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është Avigilon NVR5 PRM (252-432 TB) i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart.**

**Dëshmi: Datasheet nga prodhuesi per krahasim**

https://assets.avigilon.com/file_library/pdf/nvr/avigilon-nvr5-datasheet-en-rev2.pdf

**Fakti 4 për pretendimin ankimor 3**

**Pozicioni nr.10 ne dokumentit karakteristikat teknike - Kamera IP Bullet 6 Mpix me IR dhe analitikë, AK ka specifikuar modelin e kameres te prodhuesit AVIGILON Bullet Camera Modelin H5A 6.0 MP dhe kete mund te vertetoni edhe ne specifikmet teknike ne vijim dhe ne linkun e prodhuesit nese i beni krahasimet**

6 Mpix Bullet IP Camera with IR and analytics
- Resolution: at least 6 Megapixel (3200x1800)
- Imaging Rate: min. 25fps@6MP
- Minimum Illumination: 0.5 lux in color mode; 0 lux in monochrome mode with IR or better
- IR Range min. 50 meters
- Horizontal Field of View: at least 60°-90°
- Integrated varifocal motorized lens
- Compression H.264 or H.265
- Wide Dynamic Range (WDR)
- Privacy zones: min. 32
- Deep-Learning Artificial Intelligence:

o Auto-configuration and auto-calibration (deeplearning analytics)

o Classification of min. 50 objects simultaneously (min. people, vehicles, trucks, bicycles, buses, motorcycles)

o Auto-tracking

o Intrusion in area of interest

o Tripwire

o Object loitering detection

o Detection of stopped object

o Detection of wrong direction

o Detection of abnormal behavior in the scene based

on speed and location of movement

o Tamper Detection

- Interoperability: ONVIF (profile S, T and G)

- Local storage: at least microSD or SD slot

- Outdoor weather protection level of IP66 and impact

protection IK10 or equivalent

- Power Source: PoE and 24VDC or 24VAC

- Operating Temperature: at least -40°C to 50°C

- Should be delivered with vendor-approved junction box

for connection of all cables and all required outdoor mounting accessories

- Mount: Pole mount - vendor approved

- IEC62471 and CE certificates min.

- The Camera should be NDAA approved

Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është **Avigilon H5A Camera Line 6.0 MP** i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart.

Dëshmi: **Datasheet nga prodhuesi per krahasim**

https://assets.avigilon.com/file_library/pdf/h5a/avigilon-h5a-line-camera-datasheet-en-rev15.pdf

**Fakti 5 për pretendimin ankimor 3**

**Pozicioni nr.12 ne dokumentit karakteristikat teknike - 14 Mpix Outdoor Dome IP Camera with integrated IR, AK ka specifikuar modelin e kameres te prodhuesit AVIGILON MODEL 15C-H5A-3MH dhe kete mund te vertetoni edhe ne specifikmet teknike ne vijim dhe ne linkun e prodhuesit nese i beni krahasimet**

**14 Mpix Outdoor Dome IP Camera with integrated IR**

- Resolution: at least 14 Megapixel (at least 3x sensors with

total resolution 7500x1900)

- Imaging Rate: min. 25fps@14MP

- Minimum Illumination: 0.5 lux in color mode; 0 lux in

monochrome mode with IR or better

- IR Range min. 30 meters

- Horizontal Field of View: at least 180°- 270°

- Integrated varifocal motorized lens

- Compression H.264 or H.265

- Wide Dynamic Range (WDR)

- Privacy zones: min. 32

- Deep-Learning Artificial Intelligence:

o Auto-configuration and auto-calibration (deeplearning

analytics)

o Classification of min. 50 objects simultaneously (min.

people, vehicles, trucks, bicycles, buses, motorcycles)

o Intrusion in area of interest

o Tripwire

o Object loitering detection

o Detection of stopped object

o Detection of wrong direction

o Detection of abnormal behaviour in the scene based

on speed and location of movement

o Tamper Detection

- Interoperability: ONVIF (profile S, T and G)

- Local storage: at least microSD or SD slot

- Outdoor weather protection level of IP66 and impact

protection IK10 or equivalent

- Power Source: PoE and 24VDC or 24VAC

- Should be delivered with 60W PoE injector

- Operating Temperature: at least -40°C to 50°C

- Should be delivered with vendor-approved junction box

for connection of all cables and all required outdoor

mounting accessories

- Mount: Pole mount - vendor approved

- IEC62471 and CE certificates min

- The Camera should be NDAA approved

Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është **AVIGILON MODEL 15C-H5A-3MH** i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart.

Dëshmi: **Datasheet nga prodhuesi per krahasim**

https://assets.avigilon.com/documents/avigilon-h5a-mh-datasheet-en-h4.pdf

Fakti 6 për pretendimin ankimor 3

**Pozicioni nr.13 ne dokumentit karakteristikat teknike - 18 Mpix Outdoor Dome IP Camera with integrated IR, AK ka specifikuar modelin e kameres te prodhuesit AVIGILON MODEL 20C-H5A-4MH dhe kete mund te vertetoni edhe ne specifikmet teknike ne vijim**

**dhe ne linkun e prodhuesit nese i beni krahasimet**

**18 Mpix Outdoor Dome IP Camera with integrated IR**

- Resolution: at least 18 Megapixel (at least 4x sensors with total resolution 9500x1900)

- Imaging Rate: min. 25fps@18MP

- Minimum Illumination: 0.5 lux in color mode; 0 lux in monochrome mode with IR or better

- IR Range min. 30 meters

- Horizontal Field of View: at least 270°- 360°

- Integrated varifocal motorized lens

- Compression H.264 or H.265

- Wide Dynamic Range (WDR)

- Privacy zones: min. 32

- Deep-Learning Artificial Intelligence:

o Auto-configuration and auto-calibration (deeplearning analytics)

o Classification of min. 50 objects simultaneously (min. people, vehicles, trucks, bicycles, buses, motorcycles)

o Intrusion in area of interest

o Tripwire

o Object loitering detection

o Detection of stopped object

o Detection of wrong direction

on speed and location of movement

o Tamper Detection

- Interoperability: ONVIF (profile S, T and G)

- Local storage: at least microSD or SD slot

- Outdoor weather protection level of IP66 and impact

protection IK10 or equivalent

- Power Source: PoE and 24VDC or 24VAC

- Should be delivered with 60W PoE injector

- Operating Temperature: at least -40°C to 50°C

- Should be delivered with vendor-approved junction box

for connection of all cables and all required outdoor

mounting accessories

- Mount: Pole mount - vendor approved

- IEC62471 and CE certificates min.

- The Camera should be NDAA approved

Bazuar ne kërkesën teknike vërehet qarte qe produkti i sipërpërmendur është **AVIGILON MODEL 20C-H5A-4MH** i cili plotëson 100% te specifikimit te kërkuar me lart.

Dëshmi: **Datasheet nga prodhuesi per krahasim**

https://assets.avigilon.com/documents/avigilon-h5a-mh-datasheet-en-h4.pdf

**Duhet theksuar qe jo vetem pozicionet e cekuar me lartë i janë përshtatur prodhuesit AVIGILON por ka edhe produkete tjera qe i jane pershtatur po te njejti prodhues i cili e eshte nje prodhues i vecant dhe eshte e pamundur qe keto specifika te plotesohen me prodhues tjere dhe kështu ju keni diskriminuar të gjithë prodhuesit tjerë dhe rrjedhimisht edhe OE qe merren me sisteme te sigurisë dhe qe opereojn ne Kosovë.**

**Edhe nje gje me rendesi qe duhet ta keni parasysh qe asnjë OE nuk mund të ofrojë zgjidhje ekuivalente sepse në rastin konkret nuk ka ekuivalence, kjo duke pas**

**parasysh se specifikacioni teknik i është përshtatë 100% vetem prodhuesit AVIGILON dhe OE i cili e ka perpiluar vetevetiu kete pershkrim teknik duke ja pershtatur prodhuesit te cilin e perfaqeson.**

**Pretendimi ankimor 4:**

Dosja e tenderit është përpiluar në kundërshtim me nenin 27 paragrafin 4 të LPP-së.

**Fakte:**

Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk jenë identike, ashtu siç e parasheh LPP-ja. Në FDT, pika 2.6 vlera e parashikuar e kontratës është 1,200,000.00 €, ndërsa një njoftimin për kontratë vlera e parashikuar e kontratës është 1,350,000.00 €.

**Pretendimi ankimor 5:**

Dosja e tenderit është përpiluar në kundërshtim me nenin 29.4 dhe nenin 54.15 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik.

**Fakte:**

Në njoftimin për kontratë dhe ne FDT, pika 14.2 Siguria e kërkuar e ekzekutimit është kërkuar të jetë 10 % e vlerës së kontratës, ndërsa rregullorja specifikon se të kontrata me çmim për njësi apo me poentim kërkohet **10% e vlerës se parashikuar**.

**Pretendimi ankimor 6:**

Dosja e tenderit është përpiluar në kundërshtim nenin 53 të paragrafit 1.1 të LPP-së.

**Fakte:**

Afati për sigurim të informatave sqaruese është lënë vetëm 11 ditë, ndërsa për këtë lloj të procedurës së prokurimit kërkohet jo më pak se *njëzet (20) ditë para datës së caktuar për pranimin e tenderëve, nëse afati i caktuar kohor për pranimin e tenderëve është dyzet (40) ditë ose më gjatë.*

**Pretendimi ankimor 7:**

Dosja e tenderit është përpiluar në kundërshtim me nenin 45.7 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik.

**Fakte:**

Versionet e ndryshme gjuhësore të njoftimeve dhe dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit nuk jenë identike në lidhje me informacionin që ato ofrojnë që bie ndesh me paragrafin 45.7 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik..

**Pretendimi ankimor 8:**

Sa i përket kërkesës së parë të kapacitetit teknik profesional se Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë në vlere prej 1.350.000,00 , AK ka anashkaluar dëshmitë e tjera që duhet të jetë "kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë".

**Fakte:**

Kërkesa e parë 1 ne dosjen e tenderit tek mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk është hartuar në harmoni me neni 69 paragrafi 4.2 të LPP-së.

**Pretendimi ankimor 9:**

AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 24, paragrafin 24.7 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik

**Fakte:**

AK nuk ka ofruar informacion shtesë në kërkesën tonë të dytë., edhe përkundër se e njëjta është bërë sipas afatit të përcaktuar.

**Pretendimi ankimor 10:**

Pas kërkesës për sqarim të tenderit Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka bërë shkelje të nenit 53 paragrafi 6 të LPP-së, e po ashtu të pikës b. të paragrafit 24.3 dhe të paragrafit 45.11 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik

**Fakte:**

AK ka zbuluar identitetin e operatorit ekonomik që i ka kërkuar informatat sqaruese.

**OE Professional Alarm**

Pyetje 1
**Përgjigje 1. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 2
**Përgjigje 2. Kjo është kërkesë e caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 3
**Përgjigje 3. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 4
**Përgjigje 4. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 5
**Përgjigje 5. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 6
**Përgjigje 6. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 7
**Përgjigje 7. Këto specifika teknike nuk përfaqsojnë vetëm një prodhues të vetëm dhe nuk jan bazuar në një prodhues por janë bazuar në zgjidhje.Kjo është e pershkruar në dokumentin e Planifikimit për implementim të sistemit të Video Vëzhgimit faqe 8.**

Pyetje 8
**Përgjigje 8. Ky shënim ka mbete nga draft dokumenti. Ju lutem referonu dokunentit në gjuhën shqipe.**

Pyetje 9.
**Përgjigje 9 Kjo është kërkesë e caktuar nga Komuna e Prishtinës**

Pyetje 10.
**Përgjigje 10. Kjo duhet të vendoset nga Komuna e Prishtinës**

**OE *ELECTRONIC SHPK***

Pyetje 1
**Përgjigje 1. Ky është kriter I caktuar nga Komuna e Prishtinës**

**Pretendimi ankimor 11:**

Dosja e tenderit nuk është përpiluar në pajtim me nenin 32 të LPP-së dhe kundërshtim me nenin 45 dhe 54 të Rregullores nr. 001.2022 për Prokurimin Publik.

**Fakte:**

AK nuk e ka përdorë llojin e përshtatshëm të procedurës së prokurimit. Është përdorë procedura Kontratë Publike Kornizë, ndërsa kriter për dhënie të kontratës vetëm në dokumentin "Përshkrimi i çmimit" është përcaktuar "Çmimi më i ulët pas peshimit", kriter ky i cili përdoret vetëm në raste kur nuk dihen sasitë, kurse në rastin konkret AK-ja duhet gjithsesi të ketë një plan të zbatimit të projektit në të kundërtën projekti si i tillë nuk ka kuptim, andaj ne si OE kërkojmë që sasitë të definohen dhe të hiqet ky kriter i vlerësimit.

**Provë që AK-se nuk ka plan të zbatimit është edhe përgjigja nga AK-se**

***P.1. A ka një projekt ekzekutiv të disponueshëm të përgatitur në përputhje me kërkesat e specifikuara?***

*Përgjigja 1: Nuk ka projekt ekzekutiv për këtë aktivitet prokurimi.*

***-Lidhur me pretendimet e aktivitetit të prokuirmit në fjalë kemi shprehë shqetësimet tona edhe te KRPP-ja, si monitoruesve e Ligjit të Prokuirmit Publik.***

***Në përgjigjen e tyre zyrtare KRPP-ja ka theksuar se ka monitoruar këtë Aktivitet sipas autorizimeve të saja dhe ka lëshuar disa rekomandime qe ka vlerësuar që nuk janë në përputhje me LPP-në, Ndërsa lidhur me kërkesat tuaja dhe përgjigjet e AK, KRPP ju këshillon se sipas LPP-se keni të drejt të bëni kërkesë për sqarime dhe nëse nuk pajtoheni me përgjigjen e AK mund të veproni sipas nenit 108A dhe 109 të LPP-së.***

***Megjithatë ne nuk kemi pranuar asnjë ndryshim nga ana e AK-së.***

**Andaj si perfundim ne si pale interesi, duke u bazuar ne ato qe u ceken me lartë, bazën ligjore, faktet materiale lidhur me këtë procedure tenderuese, kërkojmë qe OSHP dhe të aprovoj si të bazuar ankesën tonë duke marr nje vendim të drejt si dhe te urdheroj AK-se qe te beje anulimin e këtij aktiviteti prokurimit dhe ta ri-tenderojë me specifikime dhe kritere të cilat u japin hapsirë për pjesmarrje ne ketë aktivitet të prokurimit edhe OE tjerë qe te dorëzojn oferta të përgjgjshme sepse me kete specifikim te pershtatura 100% prodhuesini AVIGILION dhe me keto kritere siq jane tani ne DT, mund te jete i pergjegjshem vetem nje OE per te cilin ne mendojm qe i eshte pershtatur ky specifikim teknik dhe ky OE eshte E Connect AL SH.P.K qe tashme dihet se kush do te jete edhe fituesi i kesaj kontrate.**

KRITERET PËR VLERËSIM

| **Kapaciteti teknik dhe professional:** | *Dëshmia e kërkuar dokumentare* |
|---|---|
| **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontratë në vlere prej 1.350.000,00 €. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar puneve te natyres se ngjajshme.** | **1. Një listë te kontratave të realizuara, d plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku du saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontra datën e fillimit dhe datën e përfundimit përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referen ose certifikatat për kryerje te punëve.** |
| **2. OE duhet te ofroj stafin e nevojshem per kete projekt. Stafi profesional qe duhet te angazhohet ne kete projekt a) Nje inxhinier i cili duhet te jete bachelor ose master i telekomunikacionit - shkencave kompjuterike. b) Nje inxhinier bachelor ose master i shkencave te inxhinierise elektrike c) Nje koordinator i certifikuar ne ITIL me jo me pak se 5 vite pervoje pune ne profesion d) Te kete se paku 15 punetore te profileve te ndryshme adekuat per realizimin e kontrates. Prej ketyre punetoreve se paku pese teknik duhet te jene te certifikuar nga prodhuesi i kamerave me te cilat oferton.** | **2. Lista e stafit te OE e nenshkruar dhe e vulosur Per piken a) dhe b) duhet te ofroj deshm diplomen, CV, kontraten e punes, deshmi r pervojen e punes. - Per piken c) certifikata IT CV, deshmia mbi pervojen e punes, kontrat punes ose kontrata e bashkepunimit per l projekt me OE ne fjale. - Per piken d) lista punesuarve ne origjinal, e nenshkruar dhe e vulo nga OE-ja. Lista duhet te permbaje em mbiemrin, profesionin, pozicionin dhe pervojen. Per pese tekniket e certifikuar nga prodhue kamerave te ofrohen CV-te, certifikatat, deshn mbi pervojen e punes dhe kontratat e punes. stafin e ri qe angazhohet enkas per kete proj kontratat e bashkepunimit te skanuara origjinali ose kopje te noterizuara te kontratave.** |
| **3. OE duhet qe ne kuader te stafit të emëroj me vendim ose deklare menaxherin e projektit i cili duhet te jet bachelor ose master i telekomunikacionit - shkencave kompjuterike .** | **3. OE në kuadër të stafit duhet të emëroj me ven ose deklarate menaxherin e projektit me më së p 5 vite përvojë pune pas diplomimit e dëshmuar CV, diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin r përvojën e punës -leter reference nga punedh ose çfardo dokumenti tjeter qe deshmohet per pu dhe pervojen e meparshme inxhinierike ne lemi caktuar si dhe deshmia mbi menaxhimin projekteve. Të jete në listën e të punësua (kontrate pune) ose të ketë marrëves bashkëpunimi.** |
| **4. OE duhet te kete a) Autorizimin nga prodhuesi MAF (Manufacturer Authorization Form) per NVR, kamera dhe switcha. b) Autorizimin nga** | **4. Deshmi per piken a) Autorizimin nga prodhu ne origjinal ose kopje te noterizuar nga origjinali Autorizimin apo deklaraten nga prodhuesi origjinal ose kopje te noterizuar nga origjinali Deklarata me shkrim nga prodhuesi e nenshkr** |

| | |
|---|---|
| prodhuesi per shitjen dhe mirembajtjen e pajisjeve te ofruara per NVR kamera dhe switch. c) Deklaraten me shkrim nga prodhuesi me te cilin garanton per pajisjet NVR, kamera dhe switcha per 36 muaj pas perfundimit te projektit. d) produktet e ofruara NVR, kamera dhe switch duhet te jene te certifikuara dhe ne pajtim me NDAA. | dhe vulosur ne origjinal. d) Deklarata me shk nga prodhuesi e nenshkruar dhe vulosur origjinal ose kopje te noterizuar nga origjin Sqarim Qeveria e Republikes se Kosoves Vendimin nr.07 66, te dates 23.02.2021, vendosur per ti zbatuar sanksionet ekonom nderkombetare ndaj entiteteve dhe personave fiz sipas listave te sanksioneve te vendosura Organizita e Kombeve te Bashkuara, Bashk Evropian dhe Shteteve te Bashkuara te Amerikes |
| 5. OE duhet te posedoj pajisjet teknike te nevojshme min. nje kamion me arke (korpe) per punet ne lartesi, (shtylla elektrike, etj) | 5.Deklaratat unike doganore ose kontrata fatu blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen Librezat e qarkullimit për automjetet regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje shfrytezimin, OE duhet te dorezoj e marreveshjen. |
| 6.Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë | 6.Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vend punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti punë. |

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Komuna e Prishtinës**
**Pristina Obstina-Municipality of Pristina**

**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Professional Alarm L.L.C." të datës 20.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 16.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Vendosja e kamerave në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-23-8456-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

I. **Hedhet poshtë si e palejuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Professional Alarm L.L.C." e datës 20.09.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 16.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Vendosja e kamerave në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-23-8456-2-1-1.

II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.

III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Professional Alarm L.L.C." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Professional Alarm L.L.C." (tutje "parashtruesi") me datë 20.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 16.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Vendosja e kamerave në Kryeqytet" me nr. të prokurimit 616-23-8456-2-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP").

Përmes nenit 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim mund të parashtrohet sipas afatit vijues "*Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku **pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave**. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore*". Tutje përmes nenit 5 paragrafit 1 të LPP është përcaktuar se "*Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon **deri në 16:00 në ditën e skadimit***".

Në rastin konkret data e hapjes së ofertave është përcaktuar me 26.09.2023 në ora 13:30 sipas njoftimit për kontratë të datës 16.08.2023. Kjo nënkupton se afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim ka qenë data 20.09.2023 në ora 16:00. Në anën tjetër kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është ngarkuar në sistemin eprokurimit me datë 20.09.2023 në ora 17:43. Kjo nënkupton që kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit respektivisht pas orës 16:00 në ditën e skadimit në kuptim të nenit 5 paragrafit 1 të LPP lidhur me nenin 60 paragrafit 60.1 nënparagrafit a) të RRPP.

Përmes nenit 62 paragrafit 62.1 të RRP përcaktohet se "*Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 60.1 të kësaj RRPP*". Tutje përmes nenit 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) përcaktohet se "*Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me anë të një vendimi, mund të refuzojë kërkesën për shqyrtim sipas Nenit 62 të kësaj rregullore kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit*".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin c) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 22.09.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PROFESSIONAL ALARM L.L.C.**

**Sqarim hyrës:** OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, pasi që kërkesa për rishqyrtim të cilin OE e ka parashtruar në AK në lidhje me kriteret e Dosjes së Tenderit, është konsideruar si e jashtëafatshme. Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve dhe fakteve ka dhënë përgjigje si më poshtë.

**Përgjigje në pretendimet ankimore**

OE ankues pretendon se *“Autoriteti Kontraktues, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk e ka trajtuar në pajtim me nenin 108/A, paragrafin 3.1 të LPP-së. Citoj “3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave”; dhe ne perputhje me neni 5 paragrafi 1 te LPP-se dhe ne perputhje me rregulloren 001/2022 neni 60 paragrafi 1 pika a) si dhe ne perputhje me interpretimin e Komisionit Rregullativ te Prokurimit Publik interpretimi me nr.16 i dates 22.11.2022 Elaborim i kalkulimit te diteve ne baze te neneve te lartcekura: 26.09.2023 – data e dorzimit te ofertave (dita 0) 25.09.2023 – (dita e 1) 24.09.2023 – (dita e 2) 23.09.2023 – (dita e 3) 22.09.2023 – (dita e 4) 21.09.2023 – (dita e 5) deri ne oren 16:00 sipas LPP-se neni 5 paragrafi 1 20.09.2023 ne oren 17:43 ne kemi dorzuar kerkesen per rishqyrtim. Pas kërkesës tonë për rishqyrtim pranë AK-së, kjo e fundit në platformën e-prokurimi ka ngarkuar disa përgjigje tjera dhe ka fshirë në platformën e-prokurimi të gjitha përgjigjet e mëhershme gjë që është rreptësishtë e ndaluar. Madje këto përgjigje edhe përkundër se janë dhënë 3 ditë para hapjes së ofertave AK nuk ka bërë zgjatjen e për ofertim ashtu siç kërkohet në nenin 24, paragrafin 24.5 të Rregullores nr 001/2022 për Prokurimin Publik.”*

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, nenin 60 të Rregullores së Prokurimit Publik si dhe interpretimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik atë të datës 22/11/2022, pika 16, të gjitha këto e sqarojnë shumë qartë se si duhet të llogaritet koha prej 5 ditësh, ku Operatorët Ekonomik lejohen të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim në rast se shohin se ka shkelje të supozuara në lidhje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit. Interpretimi i KRPP-së thotë si në vazhdim: *a) Kurdo që kërkesa*

*për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).*

Pra, përderisa data 26/09/2023 është dita zero, atëherë sipas legjislacionit të lartpërmendur dita 5 është data 21/09/2023, deri në ora 16:00 e cila është dita e fundit ku lejohet dorëzimi i kërkesave për rishqyrtim. Arsyetimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim si e jashtëafatshme është e gabuar, përderisa kalkulimet nuk janë bërë ashtu siç edhe e sqaruam më lartë dhe siç e kërkon edhe legjislacioni për Prokurimin Publik.

Duke u bazuar në LPP, RRPP dhe Interpretimin e KRPP, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka bërë shkelje kur i ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim si të jashtëafatshme dhe nuk i ka trajtuar fare pretendimet e ngritura. Pra, dorëzimi i kërkesës për rishqyrtim me datën 20/09/2023, pas orës 16 llogaritet se është dorëzuar me datën 21/09/2023 e cila është edhe dita e fundit për dorëzimin e kërkesave, që është shumë në rregull dhe brenda afatit.

Duke u bazuar në atë çfarë sqaruam më lartë, eksperti shqyrtues rekomandon se lënda duhet të kthehet në rishqyrtim dhe sipas LPP-së, AK duhet të jap përgjigje në të gjitha pretendimet e kërkesës për rishqyrtim të ngritura nga OE ankues, brenda afatit të paraparë ligjor.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PROFESSIONAL ALARM L.L.C.**

**Agnese Ibrahimi**